

VENDIMI I ASAMBLESE SE ZAKONSHME
NR. 3 date 08 / 03 / 2023
TE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGETARE
“LANI”sh.p.k.

Sot me date 08/03/2023 ne oren 10:00, ne seline e shoqerise “LANI” sh.p.k., rregjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.12413, date 12/10/1995, mbledhet Asambleja e Zakonshme e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise e thirrur nga Administratorja e shoqerise Znj. Elga KOSTA.

Marrin pjese:

1. Z. Vladimir KOSTA, i cili zoteron 70 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Znj. Elga KOSTA, merr pjese dhe me cilesine e administratorit te shoqerise.
3. Z. Mirton LIKA, i cili zoteron 30 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
4. Znj. Lesina Begvarfaj, Ekonomiste e Shoqerise.
5. Z. Danjel Garunja, Jurist i Shoqerise

Mbledhjen e hapi Administratorja e shoqerise Znj. ELGA KOSTA, e cila mbasi konstaton rregullsine e mbledhjes fton dhe deklaron mbledhjen e hapur per te diskutuar dhe vendosur per sa me poshte:

RENDI I DITES

1. Ortaket e kompanise kane tre prona truall, qe kerkojne ti kalojne si kontribut ne natyre me te dhena si me poshte:
 - 1.1. Truall me siperfaqe 1311 m2, Zona Kadastrale 8150 Nr.Pasurie 7/601 Vol 36 Faqe 230 me pronesi $\frac{1}{2}$ Vladimir Kosta dhe $\frac{1}{2}$ Mirton Lika e vleresuar me Raport Vleresimi date 28/04/2022 nga Vleresues Arsen Caci ne Vleren 6.850.000 Eur (Gjashtemilion e teteqind e pesedhete mije eur).



- 1.2. Truall me sipërfaqe 175 m², Zona Kadastrale 8150 Nr.Pasurie 7/649 Vol 41 Faqe 54 me pronesi ½ Vladimir Kosta dhe ½ Mirton Lika e vlerësuar me Raport Vlerësimi date 28/04/2022 nga Vlerësues Arsen Caci ne Vleren 915.000 Eur (Nentëqind e pesëmbëdhjetëmije eur).
- 1.3. Truall me sipërfaqe 45 m², Zona Kadastrale 8150 Nr.Pasurie 7/648 Vol 41 Faqe 55 me pronesi ½ Vladimir Kosta dhe ½ Mirton Lika e vlerësuar me Raport Vlerësimi date 28/04/2022 nga Vlerësues Arsen Caci ne Vleren 235.000 Eur (Dyqind e tridhjetë e pesëmije eur).
- Sa me sipër, trojet ne pikat 1.1, 1.2, 1.3 ortaket vendosin ti kalojnë si kontribut ne natyre me vleren totale 8.000.000 Eur (Tetë milion Eur) ose 920.000.000 (Nentëqind e njëzetë milion LEK), me unanimitet pa ndryshim te kuotave.*
2. Kuotat do te mbeten 70% Ortaku Vladimir Kosta dhe 30% Ortaku Mirton Lika.
3. Per rritjen e kapitalit ortaket kane menduar te miratojne ekspertit kontabel shoqeria "Auditing Partners" SHPK me NIPT K61703021H per te filluar procedurat e zmadhimit te kapitalit

Pas shqyrtimit te pikave te rendit te dites dhe pas nje diskutimi te mbeshtetur ne Statutin e shoqerise "LANI"sh.p.k.;

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise:

VENDOSI

- I. Te miratoje rritjen e kapitalit si kontribut ne natyre i ortakeve ne vleren 8.000.000 Eur e barazvlefshme me 920.000.000 LEK (Nentëqind e njëzetë milion lek).
- II. Mbas kesaj rritje te mos ndryshojne kuotat e ortakeve, kuotat do te vazhdojne te jene 70% Ortaku Vladimir Kosta dhe 30% Ortaku Mirton Lika
- III. Te miratoje ekspertit kontabel shoqeria "Auditing Partners" SHPK me NIPT K61703021H per te filluar procedurat e zmadhimit te kapitalit

LANI sh.p.k.

SKY TOWER,
Rr. Ibrahim Rugova Suite 12/4, Tirana
ALBANIA
Tel. 04 2221 666; Fax: 04 2240 688
e-mail: lanishpk@albaniaonline.net

Pas miratimit te rendit te dites, nuk u ngriten diskutime te tjera, dhe si rrjedhim Administratorja Zj.Elga KOSTA e deklaroi te mbyllur mbledhjen.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Z. Vladimir KOSTA

Vladimir Kosta

[Signature]



Z. Mirton LIKA

Mirton Lika

[Signature]